



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 124, Datë 06.05.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË  
“RREGULLOREN PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN,  
MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN OSE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E  
GAZIT NATYROR”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 97, DATË  
04.07.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 16, pika 11, 18; 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e Gazit natyror” i ndryshuar; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 19 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1527 prot., datë 06.05.2026, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017”

**Konstatoi se:**

- Në zbatim të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, është miratuar “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.
- Pas miratimit të rregullores, ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” është ndryshuar, ndër të tjera me ligjin nr. 81/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke shtuar veprimtari të reja që i nënshtrohen licencimit, si operimi në impiantet e GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla.
- Nga analiza e përmbajtjes së rregullores ekzistuese është evidentuar nevoja për përditësimin e saj, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi.
- Në këtë kuadër, janë propozuar ndryshime që synojnë harmonizimin e rregullores me ligjin nr. 102/2015, i ndryshuar, duke përfshirë shtimin e këtyre kategorive të reja të veprimtarive të licencuara, dokumentacionin, afatet dhe procedurën përkatëse për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e secilës prej këtyre veprimtarive, si dhe disa ndryshime të tjera në kuadër të saktësimit/qartësimit të përcaktimeve të rregullores.

- Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në rregullore konsistojnë në përditësimin dhe harmonizimin e bazës ligjore me ndryshimet më të fundit të legjislacionit për sektorin e gazit natyror, zgjerimin e objektit të rregullores dhe përcaktimin më të detajuar të procedurave të licencimit për aktivitetet në sektorin e gazit natyror.
- Në këtë kuadër, parashikohen përkufizime të reja për Gazin Natyror të Lëngëzuar (GNL), Gazin Natyror të Komprimuar (GNK), impiantet me përmasa të vogla, operimin, përdorimin, operatorin e tregut dhe përdoruesin e sistemit, si dhe shtohen kategori të reja licencimi për operimin e impianteve të GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla.
- Gjithashtu, riformulohen kriteret, afatet dhe dokumentacioni për aplikim, duke përfshirë kërkesa teknike, financiare, mjedisore dhe të sigurisë për çdo kategori licence, si dhe përcaktohet mundësia e dhënies së licencës me kusht dhe procedurat përkatëse të monitorimit dhe verifikimit të saj.
- Ndryshimet synojnë gjithashtu rritjen e transparencës dhe efikasitetit administrativ përmes riorganizimit të regjistrimit të licencimeve dhe publikimit të të dhënave përkatëse në faqen zyrtare të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e ndryshimeve në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017 (sipas ndryshimeve të propozuara bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit**

**AHMETI**

**Drafti i Ndryshimeve dhe shtesave në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, (miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017)**

**Neni 1 bëhet:** Kjo Rregullore hartohet në zbatim të nenit 16, pika 11 dhe neneve 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar me ligjin nr. 81/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 102/2015”; ligjin nr. 89/2018 dhe ligjin nr. 64/2018, si dhe në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, të ndryshuar.

**Neni 2 bëhet:** Kjo rregullore përcakton procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ndryshimin ose heqjen e licencave për veprimtaritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe përcakton autoritetin e ERE-s për shqyrtimin e aplikimeve, dhënien e licencave me kusht dhe vendosjen e pagesave përkatëse për çdo aplikim.

**Neni 3 shtohen përkufizimet si në vijim:**

**“Gaz Natyror i Lëngëzuar” (GNL)** është gazi metan CH<sub>4</sub>, i cili kthehet në lëng në presionin 1 atm dhe temperaturë minus 161 gradë celsius.

**“Gaz Natyror i Komprimuar” (GNK)** është gazi metan CH<sub>4</sub>, i cili komprimohet në presionin 200 atm.”.

**“Impiant me përmasa të vogla”** është njësi lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNL-së dhe/ose GNK-së.

**“Termet e përdorura në këtë rregullore, do kenë të njëjtin kuptim si ato të referuara në ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.**

**Neni 4 pika 1 shtohen gërmat:**

- ë. Operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla;
- f. Operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.

**Neni 5 bëhet:** Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një Licence të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje për transmetim, shpërndarje, depozitim dhe GNL prej ERE në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje, do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh, me të drejtë përsëritjeje. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një Licence për furnizim dhe tregtim operimi në hapësirat e gazit natyror, funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror, operimin në impiantet e GNL dhe/ose GNK me përmasa të vogla do të jetë për një periudhë prej 10 vitesh, me të drejtë përsëritjeje.

**Neni 8, pika 6, gërma “a”, ndryshon dhe bëhet :** Një kopje origjinale ose fotokopje e njehsuar me origjinalin sipas legjisllacionit në fuqi.

**Neni 9 ndryshon si vijon:**

**Pika 1 Gërma a) shtohen aktivitetet:** Operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla; Operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla dhe në tabelë bëhen shënimet si vijon:

	<b>GNL sasive të vogla</b> <input type="checkbox"/>	prodhim <input type="checkbox"/>
		depozitim <input type="checkbox"/>
		transport <input type="checkbox"/>
		shpërndarje rigazifikim <input type="checkbox"/>
	<b>GNK sasive të vogla</b> <input type="checkbox"/>	prodhim kompresim <input type="checkbox"/>
		depozitim <input type="checkbox"/>
		transport <input type="checkbox"/>
		shpërndarje <input type="checkbox"/>

**Në nenin 9 pika 1 gërma d) pika (ii) dhe (iii) ndryshojnë dhe bëhen:**

(ii) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), që vërteton se personi juridik dhe administratorit/administratorëve të shoqërisë tregtare nuk janë të dënuar.

(iii) Në rastin e subjekteve me nënshtetësi të huaj, duhet të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore të vendit të rezidencës, i përkthyer dhe i pajisur me vulë apostile.

**Në nenin 9 pika 1 gërma e), Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale; ndryshon pika (iv) dhe bëhet:**

(iv) Me përjashtim të rastit të furnizimit (neni 4.1.c), rastit të tregtimit (neni 4.1.ç), **rastit të aktivitetit të GNK-së (neni 4.1.ë) dhe rastit të aktivitetit të GNL-së (neni 4.1.f)**, një çertifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e Licencës së kërkuar. Për më tepër, i Licencuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej, ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së Licencës.

**Në nenin 9 pika 2 pas gërmës f) shtohet; emërtesa g) në titullin: “Licence për operimin e tregut”**

**Në nenin 9 pika 2 pas gërmës g) shtohet; gërmat gj);**

**gj. Licencë për operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla**

*Aplikuesi për licencim për operim në impiantet e GNL duhet të depozitojë Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:*

- i. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje) për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis;*
- ii. projektin teknik të detajuar, të hartuar nga studio e licencuar, që përmban të dhëna për impiantin, vendndodhjen e instalimeve, hartat e vendndodhjes, skemat e tubave dhe Instrumenteve (P&ID), specifikimet teknike të pajisjeve kryesore (rezervuarë kriogjenikë për GNL), si dhe kapacitetet operacionale;*
- iii. Marrëveshje paraprake për autorizimin e burimit të furnizimit me gaz nëpërmjet transaksioneve dypalëshe në baza afatshkurtra, por jo më pak se 1 (një) muaj;*
- iv. vërtetimin nga ISHTI për Inspektim të të gjitha pajisjeve për efekt të sigurisë dhe pajtueshmërisë teknike;*
- v. një dokument operacional që përmban manualin e operimit të impiantit, procedurat e mirëmbajtjes, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe politikat e sigurisë industriale;*
- vi. dokumentacion që vërteton të drejtën e përdorimit të pajisjeve.*
- vii. dëshmi për kualifikimin e stafit.*
- viii. Çdo leje tjetër sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme.*

**Në nenin 9 pika 2 pas gërmës gj) shtohet; gërma h);**

**h. Licencë për operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla**

*Aplikuesi për licencim për operim në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla duhet të depozitojë informacionin/dokumentacionin specifik si vijon:*

- i. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje) për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis;*
- ii. projektin teknik të detajuar, të hartuar nga studio e licencuar, që përmban të dhëna për impiantin, vendndodhjen e instalimeve, hartat e vendndodhjes, të dhëna për sistemet e kompresimit, skemën e stacioneve të mbushjes (nëse aplikohet).*
- iii. autorizimin e burimit të furnizimit me gaz nëpërmjet transaksioneve dypalëshe në baza afatshkurtra, por jo më pak se 1 (një) muaj;*
- iv. dëshmi të objekteve të autorizuar të magazinimit dhe mjeteve të specializuara të transportit (kamionë ose anije);*
- v. vërtetimin nga ISHTI për Inspektim të të gjitha pajisjeve për efekt të sigurisë dhe pajtueshmërisë teknike;*
- vi. një dokument operacional që përmban manualin e operimit të impiantit, procedurat e mirëmbajtjes, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe politikat e sigurisë industriale;*
- vii. dokumentacion që vërteton të drejtën e përdorimit të pronës.*
- viii. dëshmi për kualifikimin e stafit.*

**Në nenin 12 pas pikës 5 shtohen; pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11:**

*6. ERE mund të japë një vendim licencimi me kusht kur gjykon se ndonjë nga kushtet e paplotësuara nuk është thelbësor për ushtrimin e menjëhershëm të veprimtarisë dhe aplikuesi merr përsipër ta plotësojë atë brenda një periudhe të caktuar.*

*7. Periudha e plotësimit të kushtit nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të licencës me kusht, sipas nenit 24, pika 2 të ligjit nr. 102/2015.*

*8. Vendimi i ERE-s për dhënien e licencës me kusht specifikon:*

- a) kushtin e paplotësuar dhe arsyen pse konsiderohet jo thelbësor;*
- b) afatin e saktë të plotësimit të kushtit;*
- c) dokumentacionin ose provat që duhet të paraqesë i licencuari për verifikimin e plotësimit;*
- d) pasojat ligjore nëse kushti nuk plotësohet brenda afatit.*

*9. I licencuari me kusht paraqet pranë ERE-s provat e plotësimit të kushtit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të përcaktuar.*

*10. Nëse kushti plotësohet brenda afatit, ERE lëshon licencën e plotë pa kusht, duke shfuqizuar vendimin e licencës me kusht.*

*11. Nëse kushti nuk plotësohet brenda afatit, ERE fillon procedurat e heqjes së licencës sipas parashikimeve të nenit 16 të kësaj rregulloreje, duke njoftuar paraprakisht me shkrim të licencuarin.*

**Në Nenin 17 pika 4, ndryshon dhe bëhet:**

*4. Regjistri i licencimeve mbahet nga struktura përgjegjëse për licencimet në ERE, dhe përditësohet pas çdo mbledhje bordi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ky regjistër përmban këto të dhëna:*

- a. Emrin e të licencuarit;*
- b. NUIS-in dhe selinë ;*
- c. Numrin dhe serinë e licencës;*
- d. Aktivitetin e licencuar;*
- e. Zona e shërbimit,*
- f. Numrin dhe datën e vendimit të Bordit të ERE-s;*
- g. Kohëzgjatja e licencës;*
- h. Vendimet e licencimit të dhëna me kusht.*

Në Aneksin A në tabelë shtohet sa vijon:

**ANEKSI A**  
**PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI**

<b>AKTIVITETI</b>	<b>Licencim</b>	<b>Modifikim</b>	<b>Rinovim</b>	<b>Transferim licence/asetesh</b>
<i>Operimi në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla</i>	<i>1 000 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>
<i>Operimi në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla</i>	<i>1 000 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>

**Shënim:**

a) Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, duhet të ketë kryer pagesën sipas përcaktimeve të këtij Aneksi. Pagesa e aplikimit është e pakthyeshme dhe mund të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë bankare pas lëshimit të një fature elektronike nga struktura e financës në ERE, sipas kërkesës së vetë aplikuesit:

Shërbimi i komisionit të bankës (në nisje dhe mbërritje) paguhet nga aplikuesi.

b) Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, bashkëlidh Deklaratën si më poshtë:

**DEKLAROJ SE:**

- Nuk më është hequr apo refuzuar më parë një licencë për operimin në sektorin e gazit natyror brenda apo jashtë vendit.

*(Nëse aplikuesit i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, duhet të bëjë me dije arsyet dhe vendimin përkatës)*

---

---

---

---

- Jam njohur me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe angazhohem për zbatimin e tij, si dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE për operimin në sektorin e gazit natyror.
- Dokumentet dhe të dhënat e paraqitura për qëllime të këtij aplikimi janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve

të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Jam i gatshëm të paraqitem në ambientet e ERE-s në rast nevojë të zhvillimit të ndonjë seance dëgjimore në kuadër të këtij aplikimi.
- Kam kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të rregullores, në datën \_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_\_, pranë Bankës \_\_\_\_\_.
- Nuk jam i angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar në Shqipëri ose vend tjetër.  
*(Nëse aplikuesi është angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar, duhet të japë shpjegimet përkatëse)*

---

---

---

**Për aplikuesin**

---

*(emër mbiemër, nënshkrim)*